

**VENDIM**  
**Nr. 39, datë 30.9.1998**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

|                 |                                |
|-----------------|--------------------------------|
| Fehmi Abdiu     | Kryetar i Gjykatës Kushtetuese |
| Hilmi Dakli     | Anëtar i " "                   |
| Zija Vuci       | Anëtar i " "                   |
| Alfred Karamuço | Anëtar i " "                   |
| Kujtim Puto     | Anëtar i " "                   |
| Kristofor Peçi  | Anëtar i " "                   |
| Sokol Sadushi   | Anëtar i " "                   |
| Franc Jakova    | Anëtar i " "                   |

me sekretare Arta Palushi, më datë 10.9.1998, shqyrtoi në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen që i përket:

kërkues: Abdulla Struga, i përfaqësuar nga avokat Bexhet Agolli.

subjekti i interesuar: Ibrahim Hallulli, i përfaqësuar nga avokat Mark Pëllumbi

Objekti: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.106, datë 18.1.1996 i Gjykatës së Rrethit - Tiranë; vendimit nr.2212, datë 17.4.1996 i Gjykatës së Apelit - Tiranë dhe vendimit nr.1625, datë 13.11.1996 i Gjykatës së Kasacionit.

Baza ligjore: Neni 27/2 i ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 "Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut"

Gjykata Kushtetuese pasi dëgjoi përfaqësuesit e kërkuesit dhe të palës së interesuar dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

Me vendimin nr.1145, datë 29.1.1995 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve pranë Bashkisë së Tiranës kërkuesi Abdulla Struga është njohur si pronar dhe i janë kthyer 39 m2 truall në qytetin e Tiranës.

Mbi padinë e subjektit të interesuar, Ibrahim Hallulli, Gjykata e Rrethit - Tiranë, me vendimin nr.106, datë 18.1.1996 ka anuluar vendimin e Komisionit të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave vetëm për 36 m2, të cilat i ka njohur pronë të Ibrahim Hallullit.

Mbi ankimin e subjektit të interesuar, Gjykata e Apelit - Tiranë me vendimin nr.2212, datë 17.4.1996, pasi ka konstatuar se mbi truallin objekt konflikti, ai ka bërë ndërtime me lejen e organeve përkatëse, ka anuluar tërësisht vendimin e Komisionit të Kthimit të Pronave duke i njohur kërkuesit të drejtën e kompensimit për 39 m2 truall.

Kolegji Civil i Gjykatës së Kasacionit, me vendimin nr.1625, datë 13.11.1996 ka konkluduar se ankesa e paraqitur nga kërkuesi nuk përmban asnjë prej shkaqeve që sipas nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile investojnë gjykimin në Gjykatën e Kasacionit dhe për rrjedhojë ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit - Tiranë.

Parashtrimet e tij për deklarimin antikushtetues të tre vendimeve të mësipërme të gjykatave, kërkuesi i mbështet në paragrafin e dytë të nenit 27 të ligjit kushtetues nr.7692, datë 31.3.1993, i cili përcakton se "Askush nuk mund të shpronësohet, përveçse për një interes publik dhe kundrejt shpërblimit të plotë".

Gjykata çmon se vendimet e gjykatave që kanë shqyrtuar konfliktin ndërmjet kërkuesit dhe subjektit dhe subjektit të interesuar, nuk janë vendime shpronësimi. Gjykata këtë konflikt e ka shqyrtuar duke interpretuar e zbatuar ligjin nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", çka hyn plotësisht në kompetencat dhe detyrat e tyre ligjore.

Për këto arsye, Gjykata Kushtetuese duke u bazuar në nenin 26 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", unanimisht,

**VENDOSI:**

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.